

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 609 Prot.

Tiranë, më 14.09 2015

**VENDIM Nr. 92, datë 1.09.2015**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "**Për Trashëgiminë Kulturore**" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.11, të datës 1.09.2015, pasi shqyrtoi Relacion mbi verifikimin në terren, në kuadër të projektit "**Rruga Levan-Tepelenë, segmenti Damës-Memaliaj-Loti II, Km 14+575-15+480**", realizuar nga ASHA,

**VENDOSI:**

- I. Për punimet e realizuara në shkelje të vendimit Nr.9, datë 18.02.2015 të KKA, nga subjekti "VEGA-KONSTRUKSION", i cili po zbaton punimet në kuadër të projektit "**Rruga Levan-Tepelenë, segmenti Damës-Memaliaj-Loti II, Km 14+575-15+480**", DRKK Gjirokastrë bazuar në Ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003, "**Për Trashëgiminë Kulturore**" (i ndryshuar), neni 49, të marrë masa të menjëherëshme për zbatimin e sanksioneve përkatëse për kundërvajtjet administrative të kryera nga ky subjekt.
- II. Të lidhet aktmarrëveshje tre palëshe ndërmjet ASHA, ARRSH dhe një shoqërie arkeologjike të licencuar, me qëllim kryerjen e sondazheve arkeologjike, për pjesën e mbetur të segmentit të rrugës **Levan-Tepelenë, segmenti Damës-Memaliaj-Loti II**, pranë fshatit Qesarat, përballë shkollës 9 vjeçare të fshatit. Raporti i sondazheve të paraqitet në KKA e rradhës.
- III. Gjatë zbatimit të punimeve të kryhet mbikqyrja e vazhdueshme arkeologjike nga arkeologët e DRKK Gjirokastrë, në bashkëpunim me arkeologët e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**